

VENDIM
Nr. 688, datë 29.7.2015

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 332, DATË 12.3.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË
PËRGJITHSHME PËR RUAJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E INFORMACIONIT
HARTOGRAFIK, TË PËRFTUAR NGA FOTOGRAFIMI AJROR, DIGJITAL I
TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 20, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 332, datë 12.3.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6 dhe 2.7, me këtë përmbajtje:

“2.1 Në funksion të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI vendos në dispozicion të ZRPP-së hartën vektoriale të përditësuar me ndërtimet informale, sipas zonave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (bllok kadastral).

2.2 Harta vektoriale e përditësuar vihet në dispozicion në format elektronik.

2.3 Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të hartës vektoriale, ZRPP-ja informon ALUIZNI-n për gjendjen juridike të pasurive në bllokun kadastral përkatës. Për zonat kadastrale, që nuk i janë nënshtruar regjistrimit fillestar, ALUIZNI, me marrjen e informacionit nga ZRPP, kryen procedurat e njoftimit publik për 30 (tridhjetë) ditë, në një vend të përshtatshëm për konsultim publik.

2.4 ZRPP-ja përfundon, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e administrimit të hartës vektoriale, sipas rastit, procesin e korrigjimit ose të përmirësimit/përditësimit të kartelave e të hartave kadastrale, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

2.5 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, regjistrimi dhe transaksionet e pasurive të paluajtshme nga ZRPP-ja kryhen vetëm në format digjital, nëpërmjet sistemit elektronik (Albsrep). Në zbatim të kësaj pike, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) duhet të hartojë dhe të miratojë një rregullore të posaçme.

2.6 ZQRPP-ja siguron shfaqjen e hartës kadastrale në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga ASIG-u, menjëherë nga momenti i regjistrimit apo transaksionit mbi pasurinë e paluajtshme.

2.7 Brenda datës 31 mars 2016, ZQRPP-ja duhet të hartojë projektin për digjitalizimin dhe përditësim/përmirësimin e të dhënave që posedon në format analog. Implementimi i projektit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë realizohet brenda 3 (tri) viteve.”.

b) Pas pikës 10 shtohen pikat 10.1 dhe 10.2, me këtë përmbajtje:

“10.1 ASIG-u, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, harton, në përputhje me pikën 1, të nenit 16, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor” “Standardin shtetëror” të informacionit gjeohapësinor për termat e parashikuar në shkronjat “e” dhe “l”, të nenit 11, të këtij ligji.

10.2 Produkti fotogrametrik (ortofoto), i përfutur nga fotografimi ajror digjital i territorit, përdoret deri në aplikimin e produktit të fotografimit të ri ajror.”.

c) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Prodhimi i informacionit gjeografik dhe i hartave topografike në shkallë të mëdha kryhet në përputhje me vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për

përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese, gjeodezike, shqiptare (KRGJSH-2010), si metadatë”.

ç) Kudo në tekstin e vendimit, emërtimi “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Adminis-tratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave / Ndërtimeve Informale dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama